

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE
ENERGJISE**

DREJTORIA E AUDITIMIT TE BRENDSEM

RAPORT AUDITIMI

NE

**“NISMA PER TRANSPARENCE NE
INDUSTRINE NXJERRESE”**

TIRANE

PERIUDHA E AUDITUAR: 01.01.2018 - 31.12.2019

SHTATOR 2020

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

➤ *Pershkrim i subjektit dhe misioni.*

Sekretariati për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI-Shqipëri), është institucion qëndror, person juridik në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë, aktualisht në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Njësia ushtron funksionet në kuadër të anëtarësimit në organizmin ndërkombëtar “EITI-International”.

Ushtron veprimtarinë mbështetur në VKM nr.993, date 09.12.2015 “Per organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI-Shqiperi)”.

Institucioni ka mision, përmbushjen e prioriteteve dhe standardeve kombëtare, që rrjedhin si detyrim nga anëtarësimi, për të siguruar transparencë të plotë të të gjitha taksave dhe pagesave që kryhen në industrinë e naftës, gazit, minierave dhe burimeve të tjera natyrore, me kontribut material në buxhetin e shtetit, proceseve respektive, si dhe përgatitjen e menaxhimit të projekteve, për këto fusha.

Për kryerjen e veprimtarisë, për periudhën e audituar EITI është financuar nga: a) buxheti i shtetit; b) granti nga IBRD sipas marrëveshjes të miratuar me VKM nr. 397, datë 1.06.2016 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. Tf 0A1769, ndërmjet Rep.Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, konforme percaktimeve ne VKM nr.993, date 09.12.2015.

➤ *Objektivat kryesore të angazhimit auditimit bazuar në sistemet e identifikuar.*

Objekti i auditimit: Auditim mbi rregullshmërinë e funksionimit të sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit financiar, ligjshmëria e rregullshmëria e veprimtarisë financiare dhe raportimit; dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemeve.

Për identifikimin e sistemeve, grupi i auditimit u bazua në raportet e mëparshme të auditimit dhe dispozitat e organizimit dhe funksionimit, aktivitetin e kryer dhe dokumentacionin e mbajtur për periudhën objekt auditimi.

Sistemet e identifikuar, për përmbushjen e objektivave të auditimit dhe të përcaktuara në programin e miratuar të auditimit janë : a) Mbi zbatimin e rekomandimeve të lena nga auditimi i kaluar; b) Sistemi i raportimit për monitorimin e zbatimit të buxhetit; c) Sistemi i mbajtjes të kontabilitetit dhe raportimit financiar; d) Ligjshmëria dhe rregullshmëria e transaksioneve financiare, shpenzimeve të aktivitetit, si dhe pagesave të punonjesve; e) Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Qëllimi i Auditimit: Të ndihmojë subjektin në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit dhe menaxhimit financiar, në kryerjen e veprimtarisë në përputhje me aktet ligjore dhe rregullat përkatëse në fuqi, për përdorimin me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet të burimeve të institucionit.

Periudha objekt auditimi: 01.01.2018 deri 31.12.2019.

➤ **Rezultatet e auditimit, përmbledhje e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve:**

Entiteti ne realizimim te detyrave dhe objektivave per periudhen objekt auditimi, eshte organizuar dhe ka funksionuar ne perputhje me dispozitat e krijimit dhe organizimit. Per periudhen objekt auditimi ka realizuar veprimtarinë konformë misionit.

Nga struktura drejtuese e Sekretariatit për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse "EITI", Tiranë, janë marrë në analizë dhe janë realizuar rekomandimet e lëna nga auditimet e mëparshme.

Per periudhen e audituar, ne entitet eshte ngritur dhe ka funksionuar nje sistem i rregullt i monitorimit dhe analizes se zbatimit te buxhetit, për nevoja dhe në përputhje me objektivat e entitetit.

Ka funksionuar një sistemi i rregullt i mbajtjes të kontabilitetit dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomise nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësite e qeverisjes së përgjithëshme".

Në këtë sistem në drejtim të raportimit të pasqyrave financiare për vitin 2019 u evidentua se "formati 5" që ka të bëjë me "pyetësor me shënime shpjeguese", në pikën 18 nuk ka dhënë detaje të shpjeguara për fondet buxhetore të pakësuara, dhe perdorimin faktik te buxhetit në fund te vitit, gjithashtu ne piken 19 nuk jane plotësuar shënime shpjeguese sqaruese për llogari te vecanta, si debitore/kreditore te ndryshem, apo per llogari qe kane efekte ne rastet e ndryshimit te normave te amortizimit. Kjo mangesi nga auditimi vleresohet perben risk me nivel te ulet, dhe nuk ka efekte ne vlerat e raportuara per sistemin e raportimit financiar.

Sistemin e veprimeve dhe transaksioneve financiare, ka funksionuar në mënyrën e duhur, në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik"; ndryshuar me Udhëzimin nr.20 datë 17.11.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik".

Eshte respektuar struktura dhe dispozitat ligjore në drejtim të përlllogaritjes dhe pagesave të pagave të punonjesve, gjithashtu për tatimin mbi të ardhurat personale, nuk u konstatuan të meta. Ndalesat mbi pagat janë përlllogaritur në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Procedurat e prokurimeve për blerje me vlera të vogla, janë kryer konform Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Per permiresimin e sistemeve dhe magësive të konstatuara si më sipër, grupi i auditimit ka dhënë të paraqitura edhe në Aneksin nr.1, pjesë e këtij raporti, *rekomandimet përkatëse:*

- Nga drejtuesi i EITI të merren masa, për përmirësimin dhe plotësimin e sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke kërkuar pranë MFE, (Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar), përcaktimin e "nëpunësit zbatues" për EITI, në respektim dhe konformë kërkesave

dhe përcaktimeve të Ligjit 10296 date 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, date 15.10.2015, neni 12.

- Të përmirësohet për periudhat e ardhëshme sistemi i raportimit të pasqyrave financiare, në drejtim të plotësimit të pyetësorit Formati nr.5, për rubrikat 18 dhe 19, me shpjegime plotësuese të detajuara.

Opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Ne entitet janë krijuar dhe kanë funksionuar komponentet baze të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në zbatim të Ligjit nr.10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, date 15.10.2015, dhe Udhezimit të MF me nr. 30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesite e sektorit publik". *Sistemi ka cfaqur mangësi dhe kërkon përmirësim në komponentin "aktivitetet e kontrollit", për organizimin e hallkave të kontrollit të brendshëm financiar dhe përcaktimin e nepunesit zbatues të njesise, konforme kërkesave të përcaktuara në dispozitën ligjore. Kjo mangësi nga auditimi vlerësohet me risk të mesëm dhe me efekte për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.*

Vlerësimi i riskut: Mbështetur në informacionin e disponuar në vlerësimin e funksionimit të sistemeve, mangësitë e konstatuar dhe të paraqitura në këtë material, grupi i auditimit për periudhën e audituar paraqet opinionin për vlerësimin e përgjithshëm të **riskut në nivel të mesëm.**

II. HYRJE

Auditimi financiar ka për qëllim vlerësimin e rregullshërisë dhe përputhshmërisë, të planifikimit e përdorimit të fondeve buxhetore, saktësinë e regjistrimeve kontabël të transaksioneve financiare dhe rregullshmerine e raportimit financiar, vlerësimin e veprimtarisë së subjektit në pajtueshmëri me politikën, procedurat, dispozitat ligjore dhe rregulloret e miratuara, komponentët e kontrollit të brendshëm dhe lënia e rekomandimeve, për përmirësimin e menaxhimit, në të gjitha nivelet.

Auditimi u krye mbështetur në dispozitat ligjore, për sa më poshtë vijon:

- Ligji nr.114/2015, date 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm".
- Manuali për Auditimin e Brendshëm, i miratuar me Urdherin e Ministrit të Financave me nr.100, date 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik".
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
- VKM nr.993, date 09.12.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Kombëtar të Nismen për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI-Shqiperi), në kuadër të anëtarësimit në organizimin ndërkombëtar EITI-International".
- Ligji nr.9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar.
- VKM Nr.783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standarteve dhe të rregullave kontabël".
- Udhezimi i MF nr. 8, date 09.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njesite e qeverisjes së përgjithëshme".
- Udhezimi i MF nr. 30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesite e sektorit publik", të ndryshuar.
- Ligji nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar;

- UKM nr.3 date 27.1.2015 “Per proceduren e prokurimit me vlere te vogel “, i ndryshuar me Udhezimin nr.2 date 24.04.2017;
- Rregullorja e Brendeshme dhe pershkrimet e punes per EITI, miratuar me nr.146, dt.30.09.2015.
- Të ndryshme: Akte të tjera ligjore dhe nenligjore, vendime e urdheresa te tjera ne fuqi, te fushave per veprimtarine specifike dhe mbeshtetese te entitetit.

Auditimi është kryer në zbatim të planit të auditimit për vitin 2020, të miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr.8399/2, datë 18.10.2019 dhe sipas Programit të Auditimit të miratuar me nr. 1502/2, date 02.03.2020.

Auditimi u krye nga grupi i punës i përbërë nga:

Josif Lubonja, përgjegjës grupi.
Hikmet Kaso, anëtar.

III. METODA E AUDITIMIT

Metoda e përdorur në auditim është “testimi hap pas hapi” dhe e kombinuar me metodën e ekzaminimit, për të cilën u përzgjedhën transaksione specifike brenda çdo sistemi nga fillimi deri në fund, për të vlerësuar nëse njësia shpenzuese i është përmbajtur procedurave në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi si dhe për të dhënë një gjykim profesional në lidhje me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e veprimeve të subjektit të audituar.

Teknika e përzgjedhjes në mënyrë rastësore u kombinua dhe me teknika të tjera si kontrolli aritmetik (listë pagesat, përlogaritjen e pagave, faturat, ditarët analitik, etj), shqyrtimi i dokumentave mbeshtes vertetues justifikuese dhe krahasimi me dokumentin bazë të transaksionit, dhe ekzaminimin analitik (në të gjithë sistemet e audituara sipas programit).

Për çdo sistem të mbuluar me auditim u përzgjedhën mbi 25 % të transaksioneve, procedurave të zhvilluara ose të veprimeve të kryera.

IV. GJETJET KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR CDO SISTEM

Në përfundim, grupi i auditimit pasqyron vlerësimin e sistemeve, respektivisht sipas programit të auditimit, si më poshtë vijon:

1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi mëparshëm.

Auditimi i fundit në inistucionin e Sekretariatit për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse “EITI”, Tiranë, është kryer sipas programit të auditimit të miratuar me shkresën nr.2811/1, datë 13.02.2018.

Në përfundim të këtij auditimi, me shkresën nr.2811/5 datë 31.05.2018, është dërguar raporti final i auditimit dhe plani i veprimit i miratuar me rekomandimet, ku janë lënë tre rekomandime.

1. Të merren masa që për shërbime të kryera e të financuara nga donatorë vendas dhe buxheti i shtetit të zbatohen procedurat e ligjit “Për Prokurimin Publik” dhe VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Të merren masa që dokumentacioni kontraktor të jetë edhe në gjuhën shqipe në zbatim të Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë, Neni 4, pika 9.

3. Të merren masa për kryerjen e raportimit të realizimit të prokurimeve publike në përputhje me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 7/1.

Grupi i auditimit konstaton se nga drejtuesit dhe stafi i këtij institucioni janë marrë masa për të analizuar dhe zbatuar rekomandimet e lëna, rekomandime të cilat nga e grupit të auditimit konsiderohen të realizuara.

2. Sistemi i raportimit per monitorimin e zbatimit te buxhetit.

Burimet e financimit të EITI për periudhën e audituar janë:

a) Buxheti i shtetit.

b) Grandi nga IBRD sipas marrëveshjes të miratuar me VKM nr. 397, datë 1.06.2016 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. Tf 0A1769, ndërmjet Rep.Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga fondi i mirëbesimit me shumë donatorë për financimin e projektit të zbatimit të nismës të transparencës, për industrinë nxjerrëse (EITI).

Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, me shkresën nr. 4210/5 date 20.02.2018 “Dergohet detajimi i buxhetit per vitet 2018-2020”, detajuar sipas fishave me kode dhe emertime projekti, entitetit i janë akorduar fondet perkatese per vitin 2018 nga buxheti dhe si financime te huaja. Gjithashtu dhe me shkresën nr.761/4, date 22.02.2019 “Dergohet detajimi i buxhetit per vitet 2019-2021”, detajuar sipas fishave me kode dhe emertime projekti, entitetit i janë akorduar fondet perkatese per vitin 2019.

Entiteti, me shkresat nr.84 date 28.09.2018 dhe nr.104 date 07.11.2018, ka bere per 3 projekte kthime te fondeve te planifikuara per buxhetin e vitit 2018, duke dhene sqarime dhe argumentimet perkatese, dhe duke i lene te lira keto fonde per tu rialokuar ne programin “Mbeshtetja e burimeve natyrore”. Po ashtu me shkresën 9247/3 date 10.12.2019 te MIE eshte bere me dije entiteti per transferimin pjesor te fondeve buxhetore per vitin 2019, per njerin nga projektet.

Sa me siper:

Për vitin 2018, buxheti i miratuar fillimisht për EITI-n me ndryshimet e pesuara, detajuar sipas burimeve të financimit, natyrës së projekteve, paraqitet si më poshtë:

Plani fillestar	114,500,000 leke
Ndryshimet e planit	52,000,000 leke
Buxheti pas ndryshimeve	62,500,000 leke

Për vitin 2019, buxheti i miratuar fillimisht për EITI-n me ndryshimet perkatese, i detajuar sipas burimeve të financimit, dhe natyrës së projekteve, paraqitet si më poshtë:

Plani fillestar	46,900,000 leke
Ndryshimet e planit	6,000,000 leke
Buxheti pas ndryshimeve	40,900,000 leke

Evidentohet se per vitin 2018, entitetit ka lene te lira dhe ka transferuar 52.000.000 leke fonde, ose 45% te buxhetit fillestar te miratuar per vitin 2018. Ndërsa per vitin 2019, entitetit nga organi

epror (MF) i janë pakesuar fondet buxhetore të akorduara, për vlerën 6,000,000 leke, ose 12.79% të buxhetit fillestar të miratuar për vitin 2019.

(Në mënyrë të detajuar sipas programeve ndryshimet janë evidentuar në projekt raportin e auditimit)

Entiteti ka ndjekur dhe realizuar sipas projekteve fondet e akorduara, dhe ka raportuar realizimin e buxhetit krahasuar me fondet e planifikuara, sipas zërave dhe burimeve të financimit të projekteve paraqitet si më poshtë:

Për vitin 2018

					Ne lekë
Nr.	Emertimi	PLAN	FAKT	Ndryshimi (Fakt -Plan) në vlerë	Realizimi në %
1	Financim nga Buxheti	12,500,000	10,967,667	-1,532,333	87.7%
2	Financim nga IBRD	50,000,000	5,035,743	-44,964,257	10%
	TOTALI	62,500,000	16,003,410	-46,496,590	25,6%

Për vitin 2019

					Ne lekë
Nr.	Emertimi	PLAN	FAKT	Ndryshimi (Fakt -Plan) në vlerë	Realizimi në %
1	Financim nga Buxheti	10,900,000	10,611,214	-288,786	97%
2	Financim nga IBRD	30,000,000	1,898,984	-28,101,016	6%
	TOTALI	40,900,000	12,510,198	-28,389,802	26,6%

Sa më sipër evidentohet se:

Për vitin 2018 projekti “Mbështetje e vazhdimësisë për nismën për transparencë për industrinë nxjerrëse (Financim nga Buxheti)” është realizuar në masën 87.7%, të fondeve të akorduara. Projekti për “Mbështetje e vazhdimësisë për nismën për transparencë për industrinë nxjerrëse (Financim nga IBRD)” është realizuar në masën 10 %, të fondeve të akorduara.

Për vitin 2019 projekti “Mbështetje e vazhdimësisë për nismën për transparencë për industrinë nxjerrëse (Financim nga Buxheti)” është realizuar në masën 97%, të fondeve të akorduara. Ndërsa projekti për “Mbështetje e vazhdimësisë për nismën për transparencë për industrinë nxjerrëse (Financim nga IBRD)” është realizuar në masën 6 %, të fondeve të akorduara.

2.1. Entiteti ka evidentuar dhe raportuar përdorimin e fondeve të buxhetit, në mënyrë të detajuar në zëra sipas natyrës dhe destinacionit të përdorimit, si dhe përdorimi i tyre i krahasuar me planin.

Evidentohet se fondet buxhetore të akorduara janë realizuar për vitin 2018 dhe 2019 respektivisht në masën 87.7% dhe 97%, dhe për të gjitha zërat realizimi i fondeve është bërë brenda kuotave të planifikuara.

Perdorimi i buxhetit evidentohet se eshte rakorduar me degen e thesarit Tirane, per fund vitin 2018 dhe 2019.

Shpenzimet për paga për vitin 2018 janë realizuar në masen 87% ose për 1,091,192 leke me pak nga fondet e planifikuara. Kjo ka ardhur për rrjedhojë e planifikimit struktural me rritje me punonjësit, por në fakt struktura nuk është rritur për këto periudha. Gjithashtu nga efektet e faktorëve të mësipërm edhe fondet për sigurimet shoqërore nuk janë realizuar në masën e programuar, por vetëm për 73%.

Për vitin 2019, zëri i shpenzimeve për pagat dhe sigurimet shoqërore janë realizuar respektivisht në masen 99% dhe 94% të fondeve të planifikuara.

Ne drejtim të shpenzimeve operative të tjera, evidentohet se është punuar me ndjenje kursimi, si në planifikim ashtu edhe në realizimin e shpenzimeve. Entiteti ka planifikuar për vitin 2019 për këto zëra vetëm 800,000 leke fonde nga 2,400,000 leke fonde të planifikuara në vitin 2018. Entiteti ka realizuar për vitin 2019, vetëm 686,955 leke fonde nga 2,390,818 leke të realizuara në vitin 2018.

2.2 Financimi dhe përdorimi i fondeve nga Banka Botërore.

Burim financimi për projektet e EITI për periudhën e auditimit është granti nga IBRD (Banka Botërore) të miratuar me VKM nr.397, datë 1.06.2016.

Për vitin 2018, gjendja e trashëguar nga viti 2016-2017 e financimi nga BB ka qënë në shumën 64,168 USD.

Entiteti ka mbajtur evidence të rregullta për financimet dhe përdorimin e të ardhurave të këtij fondi dhe gjëndjen e parasë në fund të vitit të disbursuara nga BB.

Për periudhën objekt auditimi entiteti ka patur të disponueshme fonde në shumën 64,207 USD, dhe sipas burimeve të financimit dhe i detajuara sipas zërave është, nga financim I huaj 64,168 dhe interesa 39 \$.

Për projektet e viteve 2018 dhe 2019 entiteti ka kryer shpenzime në shumën 64,036 USD. Të detajuara shpenzimet sipas zërave dhe të ndara sipas viteve, paraqiten në projekt raportin e auditimit.

Gjendja e likuiditeteve në fund të vitit 2018 për llogarinë e projektit është 17,483 USD, ndërsa në fund të vitit 2019 gjendja e likuiditeteve paraqitet për 5 USD.

Perdorimi i fondeve kryesisht është me destinacion konsulentë dhe trajnime.

(Lidhur me rregullshmerinë e respektimit të procedurave për menaxhimin e projektit të financuar nga BB si dhe monitorimin e zbatimit të projektit, nga grupi i punës nuk u krye auditim për arsye se përdorimi i këtij fondi është investiguar nga audituesit e BB).

Në përfundim mbështetur në konstatimet sa sipër, Grupi i Auditimit evidenton se:

-Planifikimi i fondeve buxhetore është kryer në mbështetje të objektivave vjetore e afat mesme dhe në përputhje me udhëzimet e MF, mbështetur në nevojat për përmbushjen e veprimtarisë.

-Entiteti ka ndjekur celjet dhe përdorimin e fondeve në mënyrë periodike dhe progressive, dhe ka kryer rakordime me Degen e Thesarit.

-Entiteti ka azhurnuar buxhetin e saj me të gjitha ndryshimet e ndodhura gjatë periudhave, sipas urdhërave të MIE dhe MF mbështetur me shkresa përkatëse.

-Për periudhën e audituar nuk u evidentuan tejkalime mbi kuotat e fondeve të akorduara dhe miratuara sipas klasifikimeve kontabel të zerave të shpenzimeve.

-Eshte punuar me ndjenje kursimi ne realizimin e shpenzimeve operative, sidomos per periudhen ushtrimore te vitit 2019. Entiteti nuk ka detyrime të prapambetura ndaj subjekteve për periudhën afatmesme, dhe nuk planifikon perdorim fondesh buxhetore per kete qellim.

3. Sistemi i mbajtjes kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Sipas dokumentacionit te shqyrtuar mbi mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin e pasqyrave financiare, per periudhen objekt auditimi evidentohet se:

- Ne entitet eshte ngritur dhe ka funksionuar sistemi i evidentimit te veprimtarise ekonomiko financiare dhe mbajtjes te kontabilitetit.
- Mbajtja e kontabilitetit te veprimtarise dhe raportimi i pasqyrave financiare eshte bere me programin informativ Alfa Buxhetor, dhe njekoheesisht mbahen dhe ditaret e gjeneruar nga sistemi si dhe evidencat ndihmese ne exel.
- Veprimet dhe ngjarjet ekonomiko financiare, te ardhurat dhe shpenzimet, jane regjistruar ne menyre kronologjike dhe jane te mbeshtetura me dokumente urdherues justifikues.
- Jane dokumentuar te ardhurat, klasifikuar edhe sipas burimit te financimit.
- Jane dokumentuar shpenzimet e entitetit sipas natyres dhe destinacionit.
- Vlerat pasurore, aktivet e qendrueshme te trupezuara dhe gjendjet e inventarit te pasqyruara ne fund te vitit 2018 dhe 2019 jane te mbeshtetura me verifikime fizike nepermjet procesit te inventarizimit.
- Gjendja e kerkesave per arketim dhe ajo e detyrimeve, per periudhen objekt auditimi, eshte e mbeshtetur me analiza.
- Jane mbajtur rregullisht llogarite kontabel dhe saldot e llogarive analitike dhe rakordojne me llogarite sintetike.
- Pasqyrat financiare per fund vitin 2018 si dhe fund vitin 2019, rezultojne te mbyllura dhe te raportuara, me anekset perkatese.
- Raportimi i pasqyrave financiare e bilanci per vitin 2018 dhe vitin 2019, eshte bere brenda afateve, ne degen e thesarit si dhe ne organin epror te veresise direkte.
- Entiteti per periudhen objekt auditimi, nuk ka detyrime financiare te prapambetura per sherbime nga subjekte si dhe per detyrime nga vendime gjyqesore.

Ne mbajtjen e kontabilitetit, rregjistrimin e veprimeve ekonomiko financiare, dhe raportimin e pasqyrave financiare, eshte ruajtur vijimesia ne pasqyrimin ne menyre kronologjike te veprimeve dhe ngjarjeve ekonomike, eshte respektuar klasifikimi kontabel e llogarive ne paraqitjen e aktiveve dhe pasiveve te entitetit, eshte ruajtur krahasushmeria e te dhenave midis dy periudheve raportuese, si dhe mbajtur e njejta politike kontabel per tere periudhat ushtrimore.

Sipas evidences kontabel dhe paqyrave financiare te raportuara, per maredhenien me buxhetin e shtetit, ne fund te periudhave 2019 dhe 2018, entiteti EITI ka raportuar situaten e aktiveve dhe detyrime .

Nga grupi i auditimit u krye verifikimi formal i plotësimit të pasqyrave financiare, u krahasuan të dhënat e hedhura në postet e bilancit me të dhënat e ditareve. Për të dhënë opinionin për saktësinë e funksionimit të kontabilitetit, grupi i auditimit është mbështetur në të dhënat e kontabilitetit, në inventaret kontabel e fizik të kryer, në informacionet dhe shpjegimet e dhëna nga stafi i EITI, si dhe në sondazhet dhe testimet e kryera me zgjedhje, të konsideruara të mjaftueshme për mbështetjen e opinionit mbi veprimet e kryera nga tntiteti.

Gjëndjet e inventarit në fund të vitit 2019 paraqitet per 1,880,869 leke nga 1,895,911 leke ne fund te vitit 2018. Kjo gjendje rezulton e inventarizuar dhe ne raportimin financiar paraqitet sipas rezultateve te verifikimit fizik ne fund te vitit per periudhat respektive.

Kërkesat për arkëtim mbi debitorët në fund të vitit 2019 paraqiten në shumën 1,029,979 lekë të evidentuar ne zërin “Operacione me shtetin te drejta per arketim”. Në fund të vitit 2018 kerkesat per arketim jane në shumën 895,551 lekë të përbërë nga zërat “Operacione me shtetin te drejta per arketim” në vlerën 879,651 lekë dhe “debitore te ndryshem” per 16,860 leke.

Shumat jane te analizuara dhe përbëhen nga pagat e punonjesve, detyrime ndaj sigurimeve shoqerore e shëndetësore dhe detyrimi për tatimin mbi të ardhurat personale të muajit dhjetor te viteve paraardhese, si dhe nga fatura të papaguara ndaj të tretëve, dhe maredhenie me shtetin. Shumat respektive sipas viteve janë të analizuara në pasiv të bilancit në llogaritë përkatëse.

Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara janë të regjistruara në kontabilitet me vlerën e tyre historike të marrjes per 6,337,825 leke. Entiteti gjate periudhes objekt auditimi nuk ka bere shtesa dhe paksime te AQT-ve, dhe gjendja e tyre paraqitet e pandryshuar per vleren historike 6,337,825 leke.

Llogaria kontabel “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune”, në fund të vitit 2018 dhe 2019 paraqitet në vlerën 16,000 lekë dhe nuk ka patur ndryshime me ate te periudhave te mepareshme.

Posti “Inventar ekonomik”, në fund të vitit 2018 dhe 2019 është në vlerë 6,321,825 lekë dhe krahasuar me vitin 2017, paraqitet e pandryshuar.

Gjendja e tyre ne fund te periudhave ushtrimore eshte raportuar ne pasqyrat financiare per vleren neto te tyre.

Në fund të vitit 2018 paraqitet në bilanc per vleren neto në shumën 2,148,116 lekë. Per kete grup aktivesh, “makineri e paisje” dhe “inventar ekonomik” eshte llogaritur amortizimi vjetor per 586,809 leke. Ky grup paraqitet me nje amortizim te akumuluar per 4,189,709 leke.

Në fund të vitit 2019 paraqitet në bilanc per vleren neto në shumën 1,689,003 lekë. Per kete grup aktivesh, per “makineri e paisje” dhe “inventar ekonomik” eshte llogaritur amortizimi vjetor per 459,113 leke. Ky grup paraqitet ne fund te vitit 2019 me nje amortizim te akumuluar per 4,648,822 leke.

Entiteti per periudhen e audituar paraqitet vetem me gjendje ne “pasive afatshkurtera”, respektivisht 895,511 leke per fund vitin 2018 dhe 1,029,979 leke per fund vitin 2019, te cilat evidentohet se kryesisht jane detyrimet per pagat, sigurimet shoqerore dhe TAP te llogaritura per muajin e fundit. Vlera per 59,496 leke ne fund vitin 2018 dhe per 66,108 leke ne fund vitin 2019 raportuar ne llogarine “Kreditore te ndryshem”, perfaqeson detyrime per fatura uji, energji elektrike, telefoni, sherbime postare, te muajit te fundit te vitit per tu paguar.

Mbyllja dhe raportimi i pasqyrave financiare, evidentohet se eshte bere mbeshtetur ne Udhezimin e Ministrise se Financave dhe Ekonomise me nr.8 date 9.3.2018 “Per procedurat e pergatitjes, paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore ne njesite e qeverisjes se pergjitheshme”. Jane respektuar normat e amortizimit sipas grupeve dhe llogaritja e amortizimit te aktiveve afatgjata eshte paraqitur ne pasqyre te vecante analitike per cdo grupim kontabel te aktiveve.

Mbajtja e kontabilitetit dhe regjistrimi i veprimeve kontabël është mbështetur në dokumenta justifikuese vertetues, të plotesuara me të gjitha elementet që përmbushin kërkesat ligjore për të evidentuar në kontabilitet, duke respektuar planin e llogarive dhe radhën kronologjike. Nga sondazhet e kryera mbi vlerat në dokumenta dhe kontabilizimet në llogarite respektive nuk rezultuan mangësi.

Financa e EITI për përdorimin e fondeve ka rakorduar në mënyrë periodike si dhe në fund të vitit me datat 31.12.2018 dhe 31.12.2019 me Degen e Thesarit Tirane, si dhe ka nëshkruar rregullisht nxjerrjet e llogarise për marrëdhëniet me thesarin.

Entiteti ka dorëzuar në Degen e Thesarit, Tirane pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor 2018, me shkresën nr. 40 datë 20.3.2019 si dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2019, me shkresën nr. 33 datë 21.3.2020.

Sektori i financës në EITI, krahas raportimit të pasqyrave financiare për marrëdhëniet me Buxhetin, ka mbyllur dhe raportuar edhe pasqyrat financiare për marrëdhëniet me Bankën Botërore, dhe për marrëdhëniet me Donatorët, si dhe bilanc financiar të konsoliduar.

Për sistemin e mbajtjes kontabilitetit dhe raportimit financiar u konstatua parregullsi, e cila konsiston në gjetjet si më poshtë:

Titulli i Gjetjes: Rregullshmëria e raportimit të pasqyrave financiare me anekset perkatese, për vitin 2019.

Nr. i gjetjes: 1	
Subjekti i Audituar	Sektori i Shërbimeve Mbeshtetese. Zyra finance kontabilitet.
Njësitë/Subjektet e interesuar nga gjetja	EITI MIE
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar. Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.8 datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Përshkrimi i gjetjes:	Situata: Në drejtim të raportimit të pasqyrave financiare, evidentohet se “formati 5” që ka të bëjë me “pyetesor me shënime shpjeguese”, në raportimin financiar për vitin ushtrimor 2019, në pikën 18 nuk ka dhënë detaje të shpjeguara për fondet buxhetore të pakesuara, dhe përdorimin faktik të buxhetit në fund të vitit, gjithashtu në pikën 19 nuk janë plotësuar shënime shpjeguese sqaruese për llogari të vecanta, psh, debitore/kreditore të ndryshëm, apo për llogari që kanë efekte në rastet e ndryshimit të normave të amortizimit. Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.8 datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Kërkesë e pasqyrës “formati 5” pika 18 e 19.

	<p>Ndikimi/efekti: Mungese e dhenies te nje informacioni te detajuar per fondet buxhetore dhe ndryshimet e ndodhura, si dhe shpjegime plotesuese e sqaruese per ceshtje e llogari te vecanta, per perdoruesit e pasqyrave financiare</p> <p>Shkaku: Mos funksionimi i kontrollit te brendshem, nga hallka e pergjegjesit te sektorit.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut	I ulët, pasi nuk ka sjell efekte me materialitet per sistemin e raportimit te pasqyrave financiare.
Konkluzioni:	Mosplotesimi i pikes 18 dhe 19 te "formatit nr.5", nuk ka ndikuar dhe nuk ka dhënë efekte në funksionimin e sistemit te raportimit te pasqyrave financiare per vitin 2019.
Rekomandimi:	Të përmirësohet per periudhat e ardhëshme sistemi i raportimit të pasqyrave financiare, në drejtim të plotësimit të pyetësorit Formati nr.5, për rubrikat 18 dhe 19, me shpjegime plotësuese të detajuara.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit.	Në vazhdimësi, në raportimin e pasqyrave financiare.
Statusi i rekomandimit	I pranuar, nga pala e audituar.

4. Sistemi i rregullshmerine te pagesave dhe transaksioneve financiare per shpenzime te aktivitetit.

Rregullshmëria e arkëtimeve dhe pagesave të kryera nëpërmjet bankës.

Për periudhën e audituar, entiteti ka operuar me 6 llogari, me llogarinë për fondet e bankës botërore në lekë dhe në valutë (dollar), llogarinë me thesarin për buxhetin e shtetit dhe llogarinë me donatorët vendas janë në lekë dhe në valutë (euro dhe dollar).

Auditimi është përqënduar në llogarinë me thesarin për buxhetin e shtetit, pasi për veprimet me llogaritë e BB, ato auditohen për cdo vit nga auditues të Bankës Botërore, opinion, i cili u mor i mirëqenë.

Me llogarinë e thesarit janë kryer 141 veprime për shumën 10,950,806 lekë për periudhën e vitit 2018; si 139 veprime për shumën 10,611,214 lekë për vitin 2019.

Pagesat e realizuara për periudhën objekt auditimi, lidhen kryesisht me pagesat për pagat e punonjësve, kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore, pagesat për tatim në burim e tatim mbi pagë; pagesa për shpenzime për likuidim të faturave të energjisë elektrike, shpenzime uji, poste, shpenzimet e telefonisë, pagesa për udhëtime dietash brenda dhe jashtë vendit, pagesa për gjoba tatimore për shkak të mospagesës në kohë të detyrimeve tatimore (për shkak të mungesës së fondeve në periudhën përkatëse); pagesa për shpenzime pastrimi, pagesa për shpenzime për shërbime të ofruara nga të tretët prokuruar me procedurën e blerjeve me vlera të vogla, shpenzime për blerje materiale gjatë periudhave respektive për nevoja të aktivitetit, të prokuruar me procedurën e blerjeve me vlera të vogla; etj.

Likuidimi i faturave është bërë për cdo rast pas relatimit nga sektori i shërbimeve me shkrim, për realizimin e blerjes së mallrave dhe kryerjen e shërbimeve të faturuara, konform kushteve të

kontratës, duke respektuar kërkesën e përcaktuar në Ligjin nr.9228, datë 29.4.2004, “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me Ligjin Nr.9477, datë 09.02.2006, Neni 3, pika 8, për dokumentacionin bazë dhe dokumentacionin plotësues vërtetues për çdo ngjarje dhe veprim ekonomik që kryhet në këtë institucion.

Grupi auditimit kontrolloi me përzgjedhje dokumentacionin për pagesat e kryera, nga i cili rezultoi se pagesat janë të shoqëruara me dokumentacionin mbështetës justifikues e vërtetues.

Mbi rregullshmërinë e dokumentacionit të mbajtur për veprimet me arkën.

Grupi i auditimit konstaton se për vitin 2019 nuk është kryer asnjë veprim me arkë as në lekë dhe as në monedha të tjera. Gjendja e tyre si në fillim dhe në përfundim të periudhës kanë qënë 0.

Për vitin 2018 janë kryer veprime me arkë vetëm në monedhat euro dhe dollarë, këto vetëm për paradhënie për udhëtim e dieta jashtë vëndit, dhe nuk është kryer asnjë veprim në arkë me lekë. Për të dy monedhat janë kryer gjithsej 13 arkëtime dhe 14 pagesa, pra një numur i kufizuar veprimesh.

Në fund të periudhës gjendja e arkës për të dy këto monedha është 0.

Nga shqyrtimi i veprimeve dhe dokumentacionit justifikues të arkës rezultoi së veprimet e arkëtimit dhe pagesave në valutë ishin kryer me urdhër të nëpunësit Autorizues, dokumentacioni justifikues ishte i plotë dhe pa të meta.

Rregullshmeria e pagesave dhe praktikave dokumentare justifikuese për “blerjet me vlera të vogla”.

Grupi i auditimit konstaton se për periudhën objekt auditimi, nga titullari i institucionit, në përputhje me përcaktimet e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; ka dalë urdhëri: “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël” dhe urdhëri: “Për krijimin e komisionit të sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar”; konkretisht nr. 10 e 11 datë 01.02.2018; si dhe nr. 6 e 7 datë 28.01.2019, komisione që kanë vepruar në periudhat respektive.

Për vitin 2018, mbi bazën e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike dhe realizimit të tyre, janë parashikuar prokurime për investime dhe shpenzime, në total në vlerën 3,975,600 lekë me tvsh; nga të cilat 2,682,800 lekë investime.

Në fakt, për këtë periudhë, nuk është realizuar asnjë zë i parashikimeve për investime ku përfshiheshin blerja e një makine në vlerën 2,300,000 lekë si dhe blerje pajisjesh si pc; ups, diktofon dhe lap top.

Gjatë vitit 2018, për nevoja të EITI-t janë realizuar vetëm procedura prokurimi me vlera të vogla, për shpenzime me vlerë totale 248,156 lekë me tvsh; të cilat kanë të bëjnë me shpenzime për servis për pajisjen “Toshiba e-studio 2540c” në vlerën 77,000 lekë; riparim Pc në vlerën 7,000 lekë; blerje tonerash në vlerën 75,136 lekë, blerje kancelarie në vlerën 34,100 lekë, blerje materiale pastrimi me vlerë 34,920 lekë; transferim ëbsite me vlerë 20.000 lekë si dhe shpenzime për blerje biletash udhëtimi jashtë vëndit në vlerën 709,725 lekë.

Gjithashtu, mbi bazën e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike dhe realizimit të tyre, rezulton se për periudhën e vitit 2019, janë parashikuar prokurime për investime dhe shpenzime, në total në vlerën 3.300.000 lekë me tvsh; nga të cilat 960,000 lekë investime.

Në fakt për këtë vit janë realizuar prokurime në total në vlerën 9.000 lekë me tvsh, që përfaqësojnë shpenzime riparimi pajisje elektronike (fotokopje) dhe nuk është realizuar asnjë zë tjetër prokurimi i parashikuar.

Nga sa më sipër, rezulton se institucioni, për periudhën objekt auditimi ka realizuar një numur shumë të kufizuar prokurimesh publike, të gjitha me procedurë blerje me vlerë të vogël.

Në të gjitha rastet, procedura e prokurimit me vlerë të vogël është zhvilluar në rrugë shkresore, sipas të cilës anëtarët e komisionit kanë testuar tregun për të marrë tregues për çmimet e punëve/mallrave/shërbimeve, të cilat i kanë pasqyruar në procesverbalet respektive të mbajtur dhe të nënshkruar nga komisioni. Bazuar në kriterin e çmimit më të ulët, komisioni ka përcaktuar fituesin. Anëtarët e komisionit i janë drejtuar operatorit ekonomik, që ka ofruar çmimin më të ulët dhe kanë bërë blerjen e mallrave, kryerjen e punëve ose të shërbimeve. Gjatë procedurës është mbajtur procesverbali përkatës, i cili nënshkruhet nga të gjithë zyrtarët e përfshirë në proces, duke i bashkëlidhur faturat përkatëse tatimore, conform me pikën 4 të nenit 40 "Procedura e prokurimit me vlerë të vogël", të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

5. Sistemi i pagesave për pagat e punonjesve.

Respektimi i strukturës së miratuar.

Struktura e Sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, është përcaktuar me Urdhërin nr.35, datë 21.01.2013; të ish Ministrit të METE për një ndryshim në Urdhërin nr.530, datë 18.07.2011 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së sekretariatit, për ndjekjen e procedurave të antarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues, në nismëm për transparencë në industrinë nxjerrëse (EITI)", e përbërë:

- Drejtues Sekretariati 1,
- Kordinator 3,
- Përgjegjës Sektori i Shërbimeve 1,
- Sektori i shërbimeve mbështetëse 4 punonjës.

Nga auditimi rezultoi se kjo strukturë është respektuar nga institucioni.

Respektimi i ligjshmërisë e rregullshmërisë për pagesat e pagave.

Sipas pasqyrave financiare të mbyllura, shpenzimet për pagat për vitin 2018 janë në shumën 7,595,838 lekë. Po sipas pasqyrave financiare të vitit 2018, kontributi për sigurimet shoqërore e shëndetësore është në shumën 1,195,277 lekë;

Për vitin 2019, sipas pasqyrave financiare të konsoliduara, shpenzimet për pagat janë në shumën 8,618,514 lekë. Sipas pasqyrave financiare të vitit 2018, kontributi për sigurimet shoqërore e shëndetësore është në shumën 1,450,461 lekë.

Nga auditimi me zgjedhje i list-pagesave për respektimin e pagës bazë dhe pagesës së grupit për punonjesit, për periudhën objekt auditimi nuk u konstatuan të meta. Pagat bazë dhe ato të grupit ishin llogaritur sipas kategorisë së vendit punës në të cilin janë emëruar punonjesit.

Listë-pagesat janë plotësuar me të gjithë elementët përbërës të pagave, shumat përfundimtare janë të rakorduara me shumat përkatëse të listës për pagesën në bankë të pagave në llogaritë personale të punonjësve.

Përlllogaritja dhe ndalesat nga paga për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore është kryer në përputhje me kërkesat e VKM nr.167, datë 29.03.2006 "Për disa çështje në zbatim të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në R. e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të Ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në R.Shqipërisë", të ndryshuar.

Në drejtim të respektimit të dispozitave ligjore për përlogaritjen dhe pagesat për tatimin mbi të ardhurat personale, rezultoi se llogaritjet ishin kryer saktë, dhe nuk u konstatuan të meta. Ndalesat mbi pagat janë përlogaritur në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat“, i ndryshuar.

Grupi i auditimit nuk konstatoi të jenë kryer pagesa për punë jashtë kohës normale të punës, për shtesa mbi pagë, apo për orë jashtë orarit zyrtar.

Gjithashtu, grupi i auditimit, për periudhën objekt auditimi, nuk konstatoi përdorimin e fondit të vecantë për dhënie shpërblimesh për rezultate në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja social - kulturore, etj.

6. Sistemi i funksionimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

EITI, ushtron veprimtarinë mbështetur në VKM nr.993, date 09.12.2015 “Per organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Kombëtar të Nismen për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI-Shqipëri), në kuadër të anetaresimit në organizimin nderkombëtar EITI-International”. (VKM e cila ka shfuqizuar VKM-ne nr.540 date 7.7.2010 “ Per ngritjen dhe funksionimin e EITI”)

Per funksionimin e strukturave organizative dhe realizimin e detyrave dhe objektivave, entiteti për periudhën objekt auditimi është mbështetur në Rregulloren e Brendshme “Per organizimit dhe funksionimit të “ALBEITI”, miratuar nga Ministri i ish METE me Urdherin Nr. 20, dt. 20.01.2012.

Entiteti ka të percaktuar misionin e veprimtarisë së tij, si institucion “Per përmbushjen e prioritetëve dhe strategjive kombëtare për transparencë në industrinë nxjerrëse”.

Struktura e entitetit është e percaktuar në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, si dhe është miratuar nga Ministri me Urdherin nr.35, date 21.01.2013 “Per miratimin e strukturës dhe organikes së EITI”. Entiteti funksionon me strukture a) Kordinatorë dhe b) Sektori i Sherbimeve Mbështetëse, respektivisht me organike me 3 punonjës kordinatorë dhe 5 punonjës, me përgjegjës sektori mbështetës dhe 4 specialiste (në të cilët 1 specialist i financës). Te dy strukturat janë në varesi direkte nga titullari i entitetit, Drejtuesi i Sekretariatit. Për periudhën objekt auditimi, entiteti rezultoi i organizuar në respektim të kësaj strukture.

EITI për periudhën objekt auditimi dhe është drejtuar nga z.Ardit Kamberi deri në muajin Nëntor 2019, dhe aktualisht drejtohet nga z. Genci Tërpo.

Financimi i entitetit, për periudhën objekt auditimi, është bërë nga buxheti i shtetit sipas projekteve për programin e veprimtarisë së EITI, si dhe fondeve të huaja nga institucione nderkombëtare, të destinuara për veprimtarinë e entitetit. Entiteti është financuar në përputhje me percaktimet e burimeve të financimit të percaktuara në akteve ligjore e nenligjore të krijimit dhe për fushat e veprimtarisë.

Për periudhën objekt auditimi, nga data 8.8.2017 dhe aktualisht, evidentohet se në entitet “nëpunës zbatues” perkohësisht është znj.Alma Dega, kjo e konfirmuar me shkresën me nr.11059/1, date 8.8.2017, të MF, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar. *Auditimi*

evidenton se kjo punonjese eshte e vetme ne organike qe mbulon financen dhe kontabilitetin ne njesi.

EITI rezulton i regjistruar, rregullisht si ent publik me NIPT L11402452T, dhe si njesi ekonomike ka raportuar rregullisht pasqyrat financiare vjetore.

Per periudhen objekt auditimi, ka funksionuar si entitet ne varesi te MIE, konforme dispozitave te krijimit dhe rregullores te funksionimit.

Auditimi evidenton se: Entiteti per periudhen objekt auditimi, ne realizimim te detyrave dhe objektivave eshte organizuar dhe ka funksionuar ne perputhje me dispozitat e krijimit.

a) Krijimi i komponenteve baze te menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Auditimi investigoj respektimin e kerkesave te percaktuara ne ligjin per menaxhim financiar dhe kontrollin, lidhur me krijimin e komponenteve baze te menaxhimit financiar dhe kontrollit, nga ku evidenton se :

Ne drejtim te Mjedisit te Kontrollit.

Per kete komponent evidentohet se: Ne entitet jane krijuar elementet baze te mjedisit te kontrollit, bazat e politikave te menaxhimit, struktura organizative, ndarja e detyrave

funksionale, percaktimi i hierarkise, hallkat dhe forma e raportimit, politikat e menaxhimit te burimeve njerezore.

Ne drejtim te menaxhimi te riskut.

Per kete komponent, grupi i auditimit evidenton se:

Per vitin 2018 ne entitet nuk jane respetuar kerkesat per evidentimin e riskut dhe kerkesat per raportimin e vetvleresimit per komponentet e menaxhimit financiar dher kontrollit ne njesi. Ndersa per vitin 2019, eshte bere dhe raportuar rregjistri i evidentimit te riskut, konforme kerkesave te percaktuara ne nenin 21 te Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 " Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, si dhe "Manualit per menaxhimin financiar dhe kontrollin", miratuar nga Ministri i Financave me Urdherin nr.8980 date 15.7.2010, si dhe jane respetuar kerkesat per plotesimin e pyetesorit sipas komponenteve te menaxhimit financiar dhe kontrollit, percaktuar ne nenin 19 te Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010, i ndryshuar.

Aktivitetet e kontrollit.

Ne drejtim te organizimit te rregullave, procedurave dhe veprimeve, qe synojne permbushjen e objektivave te njesisë si dhe per zbatimin e vendimeve te menaxherit, evidentohet se ne entitet jane marre masa per organizimin e aktivitetit te kontrollit, lidhur me keto elemente:

Eshte bere ndarje e detyrave funksionale, duke percaktuar nivelet pergjegjese per cdo sektor dhe drejtori, per kontrollin e miratimin e proceseve te punes, eshte organizuar sistemi me dy firma per transakcionet financiare, realizimi i shpenzimeve te aktivitetit behet mbeshtetur ne planin vjetor te miratuar dhe ndiqet nga financa.

Eshte organizuar sistemi i kontrollit te aktiveve te trupezuara afatgjata dhe atyre ne perdorim, nepermjet mbikqyrjes periodike, si dhe nepermjet procesit te inventarizimit per cdo vit. Entiteti ka organizuar sistemin e mbajtjes te dokumentacionit teknik dhe ekonomiko financiar ne menyre te dubluar, si dhe ruajtjen e administrimin e tij nepermjet arshives.

-Ne kete komponent, lidhur me krijimin e hallkave te kontrollit te brendshem, kontrollet nga strukturat para faktit, si dhe kontrollet pas faktit, per te garantuar menaxhimin dhe kontrollin e veprimtarise te perdorimit te fondeve publike, auditimi evidenton se: Sistemi paraqet mangesi dhe kerkon permiresim ne organizimin e hallkave te kontrollit te brendshem financiar.

Bazuar ne dokumentacionin e shqyrtuar, evidentohet se :

Me shkresen e MF me nr.11059/1 date 8.8.2017, nga Drejtoria e Harmonizimit te Menaxhimit Financiar, eshte percaktuar se "konfirmohet perkohesisht per EITI, nepunes zbatues" shenuar edhe "pergjegjese sektori". Auditimi evidenton se kjo punonjese e percaktuar "nepunes zbatues" per periudhen objekt auditimi dhe aktualisht eshte me funksion specialiste e finances, dhe sipas struktures organike eshte punonjese e vetme ne organike per financen.

Me shkresen nr. 4414/24, date 14.6.2018, Departamenti i Administrates Publike, ka percaktuar me transferim te perhershëm ne pozicionin e Pergjegjeses te Sektorit te Sherbimeve Mbeshtetese

ne EITI, nje punonjese tjetere, dhe aktualisht ne kete detyre. Sipas struktures organike te EITI, ky funksion ka ne veresi direkte edhe financen dhe sipas detyrave funksionale pergjigjet edhe per menaxhimin financiar, mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar.

Me emerimin e pergjegjesit te Sektorit te Sherbimeve Mbeshtetese, nga titullari i EITI nuk eshte kerkuar prane Drejtoria e Harmonizimit te Menaxhimit Financiar, ne MFE, konfirmimi per nepunesin zbatues, konforme kerkesave dhe kushteve qe kerkon Ligjit 10296 date 8.7.2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ndryshuar. (grupit te auditimit gjate procesit te auditimit nuk ju paraqit asnje dokument korespondence me MF per kete ceshtje).

Nga shqyrtimi i praktikave dokumentare, evidentohet se punonjësia me funksionin financiare, kryen njekohesisht funksionin e nepunesit zbatues, funksionin e kontrollit te brendshem financiar, funksionin e mbajtjes kontabilitetit, rregjistrimit te veprimeve ekonomiko financiare, si dhe perpilimit dhe raportimit te pasqyrave financiare. Kryerja e te gjitha funksioneve nga nje punonjese e vetme ka krijuar risk dhe dobeson procesin e minimizimit te gabimeve, parregullsive shkeljeve dhe mos zbulimin e tyre.

Titulli i Gjetjes: Rregullshmëria e organizimit të hallkave të kontrollit të brëndshëm financiar, dhe përcaktimit të nëpunësit zbatues.

Nr. i gjetjes: 2	
Subjekti i Audituar	Drejtuesi i entitetit.
Njësitë/Subjektet	e EITI

interesuar nga gjetja	MIE
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligjit 10296 date 8.7.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015, neni 12.
Përshkrimi i gjetjes:	<p>Situata: Ne entitet mungon struktura përgjegjëse që lidhet me kontrollin e brendshëm brenda njësisë, për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe raportimin ekonomik financiar, e cila përgjigjet direkt para nëpunësit autorizues, titullarit të njësisë. Entiteti nuk ka të përcaktuar “nëpunësin zbatues” në respektim dhe konformë kërkesave dhe percaktimeve të Ligjit 10296 date 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, date 15.10.2015, neni 12.</p> <p>Kriteri: Ligjit 10296 date 8.7.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, date 15.10.2015, neni 12.</p> <p>Ndikimi/efekti: Mos krijimi i hallkës të menaxhimit financiar dhe kontrollit brendshëm, gjë e cila ka çënuar funksionim e kontrollit të brendshëm, konformë kërkesave të Ligjit 10296 date 8.7.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ndryshuar.</p> <p>Shkaku: Entiteti nuk ka të përcaktuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, në MFE si “nëpunës zbatues”, punonjësen e emëruar në pozicionin e Përgj. Sekt. i Shërbimeve Mbështetese, por funksionon me “nëpunës zbatues” të përcaktuar nga MFE punonjësen e cila aktualisht është me funksion specialiste e financës, dhe sipas strukture organike është punonjëse e vetme në organikë për financën dhe kontabilitetin në EITI.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesem.
Konkluzioni:	Në njësi është çënuar funksioni i kontrollit të brendshëm, konforme kërkesave të Ligjit 10296 date 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ndryshuar. Kjo ka ardhur për arsye se punonjësi i emëruar në funksionin Përgjegjës i Sektorit që ka në varësi direkte financën dhe kontabilitetin nuk është i konfirmuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, në MFE si “nëpunës zbatues” për EITI, gjë e cila ka bërë që në njësi të mos

	krijohet hallka e kontrollit të brëndshëm financiar.
Rekomandimi:	Nga drejtuesi i EITI të merren masa, për përmirësimin dhe plotësimin e sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke kërkuar pranë MFE, (Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar), përcaktimin e “nëpunësit zbatues” për EITI, në respektim dhe konformë kërkesave dhe përcaktimeve të Ligjit 10296 date 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, date 15.10.2015, neni 12.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit.	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	I pranuar, nga pala e audituar.

Informimi dhe komunikimi

Ne entitet është organizuar procesi i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit midis niveleve të ndryshme të strukturës organizative brenda strukturave si dhe me titullarin e entitetit. Është organizuar dhe ka funksionuar procesi i informimit të çdo hallke organizative për objektivat, programeve të punës, buxhetit perkates, si dhe procesi i informimit periodik nga strukturat për titullarin e entitetit.

Gjithashtu është informuar periodikisht organi epror në drejtim të realizimit të objektivave të entitetit dhe detyrave të tjera të vecanta. Nga drejtuesi i entitetit, behen analize periodike dhe vjetore e punës të EITI, dhe raportime në organin epror të varesise.

Procesi i informimit dhe komunikimit ka elementet e domosdoshem që kerkohen: a) përmban shpjegime dhe parametra faktikë sasiorë dhe cilësorë; si dhe b) pasqyron në mënyrë objektive fakte dhe rrethana lidhur me aktivitetin e entitetit apo çdo hallke që informon.

Monitorimi

Evidentohet se në entitet është organizuar procesi i monitorimit të realizimit të detyrave.

Titullari e entitetit ka aplikuar formen e berjes takimeve mujore me hallkat operative, për raportime të ecurisë dhe trajtime të problemeve të ndryshme. Gjithashtu është aplikuar forma e berjes të analizave tremujore të realizimit të detyrave nga çdo struktura si dhe analizës të realizimit të objektivave në fund të vitit ushtrimor.

Ne entitet mungon e hallka e monitorimit të veprimtaria ekonomiko financiare, nga hallkat direkte eprorë dhe nëpunësit zbatues i njesise, por ka funksionuar monitorimi nepermjet vetkontrollit nga financa.

Entiteti nuk ka struktura të veten të auditimit të brendshëm, por për rekomandimet e lena nga auditimi i brendshëm i organit epror, është bërë analize dhe janë hartuar programe të vecanta pune të detajuara për realizimin e tyre.

Per kete komponent evidenton se: Nuk eshte organizuar dhe nuk ka funksionuar ne nivelet e kerkuara, monitorimi i funksionimit te kontrollit te brendshem, te veprimtarise ekonomiko financiare, nga hallkat direkte eprore. Rekomandimet e auditimit jane trajtuar e monitoruar per realizimin e tyre.

VI. Rekomandimet e auditimit.

Në përfundim të projekt raport auditimit, grupi i auditimit per permiresimin e sistemeve dhe gjetjeve përgatiti rekomandimet e sygjera. Pas marrjes te dakortesimit me projekt raportin dhe rekomandimet, u hartua raporti perfundimtar i auditimit dhe rekomandimet sipas Aneksit 1, pjese e raportit, per te cilat nga subjekti do te përgatitet plan pune i detajuar per zbatim.

Zbatimi me rigorizitet i këtyre rekomandimeve do të bëjë të mundur vendosjen e kontrolleve të duhura si dhe do t'i japë siguri menaxhimit se këto kontrolle po funksionojnë për përmbushjen e objektivave me kosto efektive dhe në mënyrë efçente.

VII. Komentet e subjektit te audituar.

Subjekti i audituar, ka dorëzuar zyrtarisht një kopje të Projekt Raportit pa observacion me shkresën nr. 17/3, datë 03.07.2020 protokolluar në MIE me nr. 1502/4, datë 07.07.2020.


VIII. Falenderime.

Grupi i punës falenderon stafin e "EITI" Tiranë, për gadishmërinë për vënien në dispozicion të dokumentacionit dhe bashkëpunimit gjatë gjithë kohës së kryerjes të angazhimit dhe realizimin e këtij misioni auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

Josif Lubonja

Hikmet Kaso



Aneksi 1.

PERMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE

Nr.	Rekomandimet	Niveli i Riskut
1.	Nga drejtuesi i EITI të merren masa, për përmirësimin dhe plotësimin e sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke kërkuar pranë MFE, (Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar), përcaktimin e “nëpunësit zbatues” për EITI, në respektim dhe konformë kërkesave dhe përcaktimeve të Ligjit 10296 date 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, date 15.10.2015, neni 12.	I mesem
2.	Të përmirësohet per periudhat e ardhëshme sistemi i raportimit të pasqyrave financiare, në drejtim të plotësimit të pyetësorit Formati nr.5, për rubrikat 18 dhe 19, me shpjegime plotësuese të detajuara.	I ulet

GRUPI I AUDITIMIT

Josif Lubonja

Hikmet Kaso



Aneksi 2.

TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE


Subjekti i audituar EITI, ka dorëzuar zyrtarisht me shkresën nr. 17/3, datë 03.07.2020 protokolluar në MIE me nr. 1502/4, datë 07.07.2020 një kopje të Projekt Raportit (te paraqitur nga auditimi me nr.1502/3, date 17.06.2020).

Subjekti i audituar EITI, eshte dakortuesuar me ceshtjet e trajtuara ne projekt raportin e auditimit dhe ka paraqitur pa observacione, nje kopje te Projekt Raportit.

GRUPI I AUDITIMIT

Josif Lubonja

Hikmet Kaso

The image shows two handwritten signatures in black ink. The first signature is for Josif Lubonja and the second is for Hikmet Kaso. Both signatures are written in a cursive, flowing style.